

**Në bazë të nenit 43 e Statutit të Federatës së Çiklizmit të Kosovës, , në mbledhjen e
mbajtur më 19.11.2022 nxjerr këtë:**

R R E G U L L O R E
PËR PUNËN E KËSHILLIT MBIKQYRËS

Prishtinë 19.11.2022

R R E G U L L O R E

PËR PUNËN E KËSHILLIT MBIKQYRËS

Dispozitat themelore

Neni 1

Me këtë Rregullore përcaktohet mënyra e punës së Këshillit Mbikëqyrës.

Neni 2

Përbërja, kompetencat dhe fusha e veprimit të Këshillit rregullohen me Statutin e FÇK

Neni 3

Anëtari i Këshillit Mbikëqyrës nuk mundë të jetë nga radhët e delegatëve të autorizuar të kuvendit.

Neni 4

Mandati i anëtarëve të Këshillit zgjatë katër vjet, prej momentit të emrimit të ti nga Kuvendi.

Neni 5

Këshilli në fushë veprimin e vetë kryen këto punë

a) Këshilli Mbikëqyrës siguron se kontabiliteti financiar është i plotë dhe i besueshëm, dhe rishikon pasqyrat financiare, pasqyrën financiare të konsoliduar dhe raportet e audituesit të pavarur të jashtëm. Këshilli Mbikëqyrës përbëhet nga kryetari dhe dy anëtarë. Anëtarët e Këshilli duhet të kenë përvojë me çështjet financiare dhe/ose me çështjet rregullatorë dhe ligjore dhe nuk mund të përfshihen në asnjë vendim që prek veprimtaritë e FÇK -së.

b) Këshilli i Mbikëqyrës këshillon, ndihmon dhe mbikëqyr Bordin lidhur me monitorimin e çështjeve financiare dhe të Mbikëqyrës së FÇK -së, vendos mekanizmat e Auditit dhe monitoron pajtueshmërinë me rregulloret përkatëse të FÇK -së. Këshilli mbikëqyrës siguron se kontabiliteti financiar është i plotë dhe i besueshëm dhe rishikon pasqyrat financiare, pasqyrën financiare të konsoliduar dhe raportet e auditorëve të pavarur dhe të jashtëm. Këshilli i Mbikëqyrës, me ndihmën e Sekretariatit të Përgjithshëm, zbaton një program pajtueshmërie brenda FÇK -së.

Neni 6

Kuvendi dhe Bordi dhe të gjithë trupat punues të tij janë të obliguar që Këshillit Mbikëqyrës t'ia mundësojnë mbikëqyrjen e punës dhe statutit të tyre.

Neni 7

Këshillit Mbikëqyrës përcjellë ligjshmërinë e punës së bordit dhe trupave punuese ndërmjet dy kuvendeve dhe mbikëqyrë afarizmin financiar të Federatës së Çiklizmit

Neni 8

Këshillit Mbikëqyrës për punën e vetë i raporton Kuvendit të Federatës së Çiklizmit. Mënyra e punës dhe procedimi i vendimmarrjes.

Neni 9

Anëtarët e Këshillit duhet të punojn pa presione, dhe ti respektojnë vendimet e statutit të Federatës së Çiklizmit si dhe rregullat që janë në fuqi të hartura nga Kuvendi dhe Bordi i saj.

Neni 10

Anëtarët e Këshillit për punën e vetë i përgjigjen Kuvendit dhe për mos funksionalitet e tij.

MËNYRA E VENDOSJE

Neni 11

Votimi në mbledhje është i hapur. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës duhet të votojnë “PËR”, apo “KUNDËR” Së pari thirren të votojnë ata që janë “PËR”, pas tyre ata që janë “KUNDËR”.

Neni 12

Kjo Rregullore hyn në fuqi nga dita e miratimit të saj. Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje.

Neni 13

Interpretimin e kësaj Rregulloreje e bënë Kuvendi

Prishtinë më 19.11.2022

Për Federatën e Çiklizmit të Kosovës

Kryetari

Avni Nuha